

**Energji Ashta sh.p.k**  
**Raporti i Auditorit të Pavarur**  
**dhe Pasqyrat Financiare**  
**për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010**

## Përmbajtja

	<u>Faqe</u>
Raporti i auditorit të pavarur	1
Bilanci kontabël më 31 dhjetor 2010	2
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010	4
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010	5
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010	6 – 28

## RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

### Drejtuar aksionarëve dhe drejtimit të Energji Ashta sh.p.k.

#### *Raport mbi pasqyrat financiare*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Energji Ashta sh.p.k bashkangjitur, të cilat përfshijnë bilancin kontabël më 31 dhjetor 2010, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit monetar për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

#### *Përgjegjësia e Drejtimit për pasqyrat financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

#### *Përgjegjësia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethanat të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

#### *Opinionit*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2010, si dhe rezultatit e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Tiranë, Shqipëri  
20 qershor 2011

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.al/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

**Energji Ashta sh.p.k**  
 Bilanci kontabël më 31 dhjetor 2010  
 (Shumat jane në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
<b>Aktivët</b>			
<b>Aktivët Afatshkurtra</b>			
Mjete monetare në arkë dhe bankë	6	4,484,879,936	4,049,331
Aktive të tjera afatshkurtra	7	1,081,182,667	15,628,871
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	5,920,852	-
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>5,571,983,455</b>	<b>19,678,202</b>
<b>Aktivët Afatgjata</b>			
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara			
Aktive afatgjata në proces	10	13,015,743,244	3,811,140,774
Makineri dhe pajisje	9	1,939,532	831,403
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>13,017,682,776</b>	<b>3,811,972,177</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>18,589,666,231</b>	<b>3,831,650,379</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali i nënshkruar		5,721,576,500	125,000,000
Humbjet e akumuluar		(252,132,840)	(36,698,781)
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>		<b>5,469,443,660</b>	<b>88,301,219</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata	11	46,820,487	-
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	4,584,389,111	1,449,936,591
Të pagueshme ndaj furnitorëve	13	798,423,205	233,994
Detyrime të tjera	14	859,187,520	2,293,178,575
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>6,288,820,323</b>	<b>3,743,349,160</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Huatë afatgjata	11	6,666,569,777	-
Detyrim për komision mirëmbajtje	15	164,832,471	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>6,831,402,248</b>	<b>-</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>18,589,666,231</b>	<b>3,831,650,379</b>

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 6 – 28.

**Energji Ashta sh.p.k**

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009
Të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit		-	-
Shpenzime të personelit	16	(17,831,144)	(939,062)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi		(318,361)	-
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	17	(102,187,084)	(41,971,623)
<b>Rezultati nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>(120,336,589)</b>	<b>(42,910,685)</b>
Të ardhura nga interesat e të tjera		592,867	427,341
Shpenzime për interesa e të tjera		(37,867)	-
(Humbje)/fitime nga kurset e këmbimit, neto	18	(95,652,470)	4,026,764
<b>(Humbje)/të ardhura financiare, neto</b>		<b>(95,097,470)</b>	<b>4,454,105</b>
<b>Humbje para tatimit</b>		<b>(215,434,059)</b>	<b>(38,456,580)</b>
Shpenzimet e tatim fitimit	19	-	-
<b>Humbja neto e vitit</b>		<b>(215,434,059)</b>	<b>(38,456,580)</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse, neto		-	-
<b>Totali i humbjeve gjithpërfshirëse të vitit</b>		<b>(215,434,059)</b>	<b>(38,456,580)</b>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 6 – 28.

**Energji Ashta sh.p.k**  
 Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2010  
 (Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Fitime te pashperndara	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2009</b>	<b>125,000,000</b>	<b>1,757,799</b>	<b>126,757,799</b>
Humbja e vitit	-	(38,456,580)	(38,456,580)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>(38,456,580)</b>	<b>(38,456,580)</b>
<b>Transaksione me aksionarët regjistruar direkt në kapital</b>			
Kontribut nga aksionarët	-	-	-
<b>Totali transaksioneve me aksionarët</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2009</b>	<b>125,000,000</b>	<b>(36,698,781)</b>	<b>88,301,219</b>
Humbja e vitit	-	(215,434,059)	(215,434,059)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>(215,434,059)</b>	<b>(215,434,059)</b>
<b>Transaksione me aksionarët regjistruar direkt në kapital</b>			
Kontribut nga aksionarët	5,596,576,500	-	5,596,576,500
<b>Totali transaksioneve me aksionarët</b>	<b>5,596,576,500</b>	<b>-</b>	<b>5,596,576,500</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2010</b>	<b>5,721,576,500</b>	<b>(252,132,840)</b>	<b>5,469,443,660</b>

Pasqyrat e ndryshimit në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 6 – 28.




**Energji Ashta Shpk**

Pasqyre e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010

*(Shumat jane ne leke, pervec rasteve kur parashikohet ndryshe)***Pasqyra e flukseve monetare me 31 dhjetor 2010**


	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2009
<b>Veprimtarite e operimit</b>		
Fitimi netor per kete periudhe	(215,434,059)	(38,456,581)
<i>Rregullime per:</i>		
Amortizimi	318,361	-
Interesi dhe te ardhura te tjera	(592,867)	(427,341)
Interesi dhe shpenzime te tjera	65,603	-
Fitimi operativ perpara ndryshimeve ne kapitalin punues	<b>(215,642,961)</b>	<b>(38,883,922)</b>
Ndryshime ne aktive te tjera	(1,058,482,282)	(15,518,871)
Pakesim (rritje) ne detyrimet ndaj paleve te lidhura	798,189,211	1,448,050,869
Ndryshime ne detyrime tregtare per t'u paguar	(1,433,881,054)	233,994
Rritje (pakesim) ne detyrime te tjera per t'u paguar	3,134,452,471	1,161,443,251
<b>Flukset monetare nga aktivitetet</b>	<b>1,389,467,905</b>	<b>3,685,765,934</b>
Tatime mbi te ardhurat afashkurtra te paguara	(7,361,337)	(179,823)
Interesa te arketuara	31,367,062	427,341
Interesa te paguara	(149,189,987)	-
<b>Paraja neto nga veprimtarite e operimit</b>	<b>1,264,283,644</b>	<b>3,685,013,452</b>
<b>Fluksi i parave nga veprimtarite investuese</b>		
Investime ne aktivet afatgjata materiale ne proces	(9,039,563,050)	(3,811,140,774)
Blerja e aktive te tjera afatgjata materiale	(1,426,490)	(831,403)
<b>Paraja neto e perdorur ne veprimtarite investuese</b>	<b>(9,040,989,540)</b>	<b>(3,811,972,176)</b>
<b>Fluksi i parave nga aktivitetet financiare</b>		
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksionar	5,596,576,500	-
Hyrje nga emetim i borxhit	6,660,960,000	-
<b>Paraja neto e perdorur ne veprimtarite financiare</b>	<b>12,257,536,500</b>	<b>-</b>
<b>Rritja (rënia) neto e mjeteve monetare</b>	<b>4,480,830,604</b>	<b>(125,958,724)</b>
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabël	4,049,331	130,008,054
<b>Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabël 31 dhjetor</b>	<b>4,484,879,935</b>	<b>4,049,330</b>

Keto pasqyra financiare jane autorizuar te hartohen nga administratoret e shoqerise "Energji Ashta" shpk me 31 mars 2010, e te nenshkruar ne emer te:



Stelzer Peter

Administrator

Reiner Dietmar

Administrator

Pasqyrat e flukseve monetare duhet te lexohen se bashku me shenimet shoqeruese si pjese perberese e pasqyrave financiare te paraqitura ne faqet 6 - 27.



## **Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsytrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

### **1. TË PËRGJITHSHME**

Energji Ashta Sh.p.k. ("Shoqëria") është themeluar më 11 dhjetor 2008 në Tiranë, Shqipëri, me qëllim zbatimin e Marrëveshjes së Konçesionit nënshkruar me qeverinë e Shqipërisë, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentralit të Ashtës dhe objekteve të tjera të lidhura me të.

Energji Ashta Sh.p.k. zotërohet 50% nga VERBUND-International GmbH dhe 50% nga EVN AG. Energji Ashta Sh.p.k. është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 11 dhjetor 2008.

Më 30 mars 2010, në bazë të vendimit të Asamblesë së Aksionarëve, kapitali aksionar i Shoqërisë është rritur me 1,162,336,500 LEK me kontributit në para.

Më 28 gusht 2010, u nënshkrua marrëveshja për blerjen e aksioneve midis aksionarit të vetëm të Shoqërisë dhe EVN A.G. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, 50% e kapitalit me një vlerë nominale prej 643,668,250 LEK iu transferua EVN A.G.

Më 17 dhjetor 2010, në bazë të vendimit të Asamblesë së Aksionarëve, kapitali i Shoqërisë u rrit me 4,434,240,000 LEK me kontribut në para nga secili prej aksionarëve, në shumën prej 16 milion Euro.

Adresa e regjistruar e manaxhimit dhe selia qendrore është: Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Pallatet Green Park, Kulla 2, Kati 2, Tirana, Albania.

Kapitali i nënshkruar, i paguar është i regjistruar në Lek. Më 31 dhjetor 2010, Shoqëria ka 8 të punësuar (2009:1).

### **Marrëveshja e Konçesionit**

#### *Pershkrimi i marrëveshjes*

Sipas Nenit 100 të Kushtetutës dhe Nenit 21 të Ligjit nr. 9663 "Mbi Konçesionet" i ndryshuar datë 18 dhjetor 2006, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 27 i titulluar "Mbi aprovimin e rregullave të vleresimit dhe dhënien e konçesioneve", datë 19 janar 2007, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1363, i titulluar "Mbi aprovimin e Marrëveshjes Konçesionare ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Österreichische Elektrizitätswirtschafts – Aktiengesellschaft, për ndërtimin, pronësinë, përdorimin, dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në Ashtë, në Republikën e Shqipërisë", datë 22 tetor 2008, Qeveria e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës ("METE"), hyri në Marrëveshjen Konçesionare më datë 17 tetor 2008 ("Marrëveshja Konçesionare").

Ky konçesion hidrocentrali përfshin planifikimin, ndërtimin, financimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një centrali me 2 nivele Hydromatrix në lumin Drin në pjesën veriore të Shqipërisë, me një kapacitet të instaluar prej të paktën 48 MW. Energji Ashta Shpk është themeluar në dhjetor 2008 si Shoqëria e projektit për këtë projekt infrastrukture. Në lidhje me hidrocentralin, planin e ndërtimit, objektet ekzistuese (duke përfshirë kaskadën dhe gjirin e hidrocentralit në Spatharë, pritave të bëra nga dheu dhe guret), të drejtat e rrugëve dhe të drejtat mbi ujën do të transferohen Energji Ashta Shpk.

Projekti i infrastruktures është organizuar si një model operimi (Build Own Operate Transfer, BOOT) dhe do të zgjasë 35 vjet. Pas kësaj periudhe, hidrocentrali do t'i transferohet METE-s pa asnjë tarifë së bashku me pajisjet përkatëse, të drejtat dhe kontratat. Verbund Group nuk ka asnjë të drejtë të zakonshme përfundimi.





## **1. TË PËRGJITHSHME (VAZHDIM)**

### **Marrëveshja e Konçesionit (vazhdim)**

Për 15 vitet e para pas komisionimit do të ketë një marrëveshje fikse për blerjejen e energjisë (take-or-pay off-take marrëveshje) me Korporaten Elektroenergetike Shqiptare (KESH), furnizuesi i energjisë i zotuar nga shteti shqiptar. Pas përfundimit të marrëveshjes së blerjes së energjisë elektrike, Verbund Group ka të drejtë të zgjasë marrëveshjen ose të shesë energjinë e prodhuar në tregun e hapur.

#### *Detyrime dhe të Drejta të Përgjithshme*

Qeveria e Shqipërisë dhe Shoqëria hyn në këtë Marrëveshje Konçesionare me qëllim përcaktimin e termave dhe kushteve, sipas të cilave Shoqëria do të ketë të drejtë, *inter alia*,

- (i) planifikimin, financimin, ndërtimin, testimin, zotërimin, operimin, dhe mirëmbajtjen e hidrocentralit;
- (ii) përmirësimin dhe rinovimin e objekteve ekzistuese, zotërimin e objekteve ekzistuese të përmirësuara dhe rinovuara në përputhje me Ligjin dhe përdorimin dhe mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese;
- (iii) gëzimin e uzufuktit;
- (iv) të ketë akses dhe të përdorë ujin në zonën me nivelin më të ulët të lumit Drin (në zonën e Konçesionit) ;
- (v) të furnizojë KESH-in me prodhim të perkohshëm neto të energjisë elektrike dhe me prodhim neto të energjisë elektrike dhe të mbledhë pagesat e blerësve të lidhur në përputhje me afatet dhe kushtet e Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë (afatet e parashikuara në Marrëveshje), dhe shitjen ndaj palëve të treta të prodhimit neto të energjisë elektrike në një treg të hapur;
- (vi) kthimin tek Qeveria e Shqipërisë (“Pala Kontraktuale”), të përdorimit të zonës konçesionare dhe të së drejtës për transferim, dhe transferimin tek Autoriteti Kontraktual të pronësisë së hidrocentralit dhe objekteve ekzistuese me përfundimin e periudhës së konçesionit;
- (vii) Konçesionari do të ketë të drejtë ekskluzive mbi çdo atribut mjedisor të gjeneruar nga projekti, duke përfshirë certifikatat përkatëse.

Konçesionari është dhënë për një periudhë prej 35 vjetesh duke filluar nga 17 tetor 2008 (“Periudha e Konçesionit”)

**2. BAZAT E PËRGATITJES**

**a. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK)

**b. Bazat e llogaritjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, me përjashtim të aktiveve të zhvlerësuarra (nëse ka) dhe instrumentave financiare derivative (nëse ka), instrumentave financiare matur me vlerë të drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe aktiveve të mbajtura për shitje të cilat maten me vlerë të drejtë.

**c. Monedha funksionale**

Në mënyrë që të permbushen kërkesat e raportimit sipas ligjit shqiptar të Kontabilitetit, pasqyrat financiare janë prezantuar në përputhje me SKK në Lekë (Lek) si monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes nga pikëpamja e raportimit stautor në Shqipëri. Drejtimi ka përcaktuar se monedha funksionale e Shoqërisë është Euro. Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit, ku bën pjesë dhe Shoqëria mëmë, janë përgatitur duke përdorur Euro-n si monedhë funksionale.

**d. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SKK paraqet nevojën që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekte të ndjeshme në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimin 5 të pasqyrave financiare.

**e. Ndryshimet në politikat kontabël**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2010 nuk janë pasqyrat e para financiare vjetore në përputhje me SKK. Më poshtë paraqitet një rakordim i informacionit krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor në përputhje me SKK me pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009 të publikuar nga Shoqëria.

**Energji Ashta sh.p.k**  
 Shënime mbi paqsytrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010  
 (Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

**2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)**

**e. Ndryshimet në politikat kontabël (vazhdim)**

Rakordimi i bilancit kontabël më 31 dhjetor 2009:

	Shënime	SNRF	Efektet e ndryshimeve	SKK
<b>Aktivet</b>				
<b>Aktivet Afatshkurtra</b>				
Mjete monetare në arkë dhe bankë		4,049,331	-	4,049,331
Aktive të tjera afatshkurtra		15,518,871	110,000	15,628,871
Parapagime dhe shpenzime të shtyra		-	-	-
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>19,568,202</b>	<b>110,000</b>	<b>19,678,202</b>
<b>Aktivet Afatgjata</b>				
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara		-	3,811,140,774	3,811,140,774
Aktive afatgjata në proces	(a)	831,403	-	831,403
Makineri dhe pajisje		1,634,876,959	(1,634,876,959)	-
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	(a)	-	-	-
Të arkëtueshme nga marrëveshja e konçesionit	(a)	2,242,827,280	(2,242,827,280)	-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>3,878,535,642</b>	<b>(66,563,465)</b>	<b>3,811,972,177</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>3,898,103,844</b>	<b>(66,563,465)</b>	<b>3,831,650,379</b>
<b>Kapitali aksionar</b>				
Kapitali i nënshkruar		125,000,000	-	125,000,000
Fitimi/(humbja) e vitit financiar	(a)	24,046,610	(60,745,391)	(36,698,781)
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>		<b>149,046,610</b>	<b>(60,745,391)</b>	<b>88,301,219</b>
<b>Detyrimet</b>				
<b>Detyrimet afatgjata</b>				
Detyrimi për tatim fitimin e shtyrë	(b)	5,818,074	(5,818,074)	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>5,818,074</b>	<b>(5,818,074)</b>	<b>-</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>				
Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata		-	-	-
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		1,449,936,591	-	1,449,936,591
Të pagueshme ndaj furnitorëve		233,994	-	233,994
Detyrime të tjera		2,293,068,575	110,000	2,293,178,575
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>3,743,239,160</b>	<b>110,000</b>	<b>3,743,349,160</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>3,898,103,844</b>	<b>(66,453,465)</b>	<b>3,831,650,379</b>

**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsytrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010


*(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***2. BAZAT E PERGATITJES (VAZHDIM)****e. Ndryshimet në politikat kontabël (vazhdim)**

Rakordimi i pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009

	Shenime	SNRF	Efektet e ndryshimit	SKK
Të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(c)	3,811,061,774	(3,811,061,774)	-
Të ardhura të tjera	(d)	232,179	(232,179)	-
Kosto ndërtimi	(c)	(3,811,061,774)	3,811,061,774	-
Shpenzime të personelit		(939,062)	-	(939,062)
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	(d)	(42,203,802)	232,179	(41,971,623)
<b>Rezultati nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>(42,910,685)</b>	<b>-</b>	<b>(42,910,685)</b>
Të ardhura nga interesat	(a)	66,990,806	(66,563,465)	427,341
Shpenzime për interesa		-	-	-
Fitime nga kurset e këmbimit, neto		4,026,764	-	4,026,764
<b>Të ardhura financiare, neto</b>		<b>71,017,570</b>	<b>(66,563,465)</b>	<b>4,454,105</b>
<b>Humbje para tatimit</b>		<b>28,106,885</b>	<b>(66,563,465)</b>	<b>(38,456,580)</b>
Shpenzimet e tatim fitimit	(b)	(5,818,074)	5,818,074	-
<b>Fitimi/(humbja) neto e vitit</b>		<b>22,588,811</b>	<b>(60,745,391)</b>	<b>(38,456,580)</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse, neto		-	-	-
<b>Totali i humbjeve gjithpërfshirëse të vitit</b>		<b>22,588,811</b>	<b>(60,745,391)</b>	<b>(38,456,580)</b>

**Shënime mbi rakordimin e kapitalit më 1 janar 2009 dhe fitimit për vitin 2009**

- Në bazë të kërkesave të KNIRF 12 "Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit", Shoqëria duhet të njohë aktive të qëndrueshme të patrupezuara, duke përfshirë ndër të tjera makineri dhe pajisje të përdorura gjatë periudhës së konçesionit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk parashikojnë trajtimin e KNIRF 12 "Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit", kështu efektet e ndryshimeve paraqesin riklasifikimin e kostove të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara dhe aktiveve financiare si makineri dhe pajisje si dhe çrregjistrimin e të ardhurave nga interesi që njihen në bazë të interpretimit të KNIRF 12.
- Tatim fitimi i shtyrë nuk njihet nga SKK. Shuma e efektit të ndryshimit përfaqëson njohjen e detyrimit të tatim fitimit të shtyrë, neto më 31 dhjetor 2009.
- Sipas SNK, të ardhurat njihen me të njëjtën shumë të kostove të ndërtimit të përfunduara gjatë vitit. SKK nuk i parashikon këto trajtime.
- Këto janë riklasifikime të kryera nga Shoqëria.



### **3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL**

#### **a. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lekë dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në Lekë me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë

#### **b. Instrumentat financiare**

Shoqëria mban vetëm instrumenta financiar jo derivative, përfshirë llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, para dhe ekuivalentë të saj, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, ndërsa instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Paraja dhe ekuivalente të saj nënkupton paranë në arkë, llogaritë afatshkurtra bankare, të tjera investime afatshkurtra me likuiditet të lartë me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk janë subjekt risku për ndryshime të rëndësishme në vlerën e drejtë të tyre dhe që janë përdorur nga Shoqëria për manaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

##### *Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi

##### *Llogaritë e detyrimeve tregtare dhe të tjera*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Politikat kontabël lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet financiare përshkruhen tek shënimi 3.(j).



**3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

**c. Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara**

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk parashikojnë Marrëveshje Konçesionare të Shërbimit. Shoqëria ka njohur kostot e ndërtimit nëpërmjet Marrëveshjes së Konçesionit sipas SKK 5 "Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara". Këto aktive njihen fillimisht me kosto.

**i. Njohja dhe matja**

Të gjitha aktivet e qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin ose amortizimin e akumuluar (kjo çështje diskutohet gjithashtu në shënimin 3.(f).

Kosto e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe koston direkte të punës, çdo kosto tjetër e përfshirë direkt në sjelljen e aktivitetit në kushte pune për qëllimin e përcaktuar, koston e çmontimit dhe largimit të pjesëve dhe restaurimit të vendit në të cilin ato ishin vendosur si dhe koston e kapitalizuara të huamarrjes.

Kur pjesë të një prone, makinerie dhe pajisje kanë jetë-gjatësi të ndryshme, ato llogariten si pjesë të ndara (pjesë të rëndësishme) të pronave, makinerive dhe pajisjeve. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë njësie prone, makineri dhe pajisje janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të tyre dhe janë pasqyruar neto në zërin "të ardhura të tjera" të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

**ii. Kostot e mëpasshme**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një njësie të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

**iii. Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e amortizimit mbi vlerën e mbetur, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhën aktuale dhe periudhat krahasuese është përshkruar më poshtë:

Jeta e dobishme	Vitet
Përmirësime të ambjenteve me qira	20
Makineri dhe pajisje	5
Mjete transporti	5
Pajisje zyre dhe informatike	4

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen çdo fund viti financiar dhe rregullohen nëse gjykohet e përshtatshme. Prona nën marrëveshjen e konçesionit nuk ka përfunduar ende, kështu që ende nuk ka nisur amortizimi.

**3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

**d. Aktivet e dhëna me qera**

Qirate sipas termave të cilave Shoqëria merr përsipër të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, janë klasifikuar si hua financiare. Gjatë njohjes fillestare aktivi i marrë me qira është matur me një shumë të barabartë me shumën më të ulët midis vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të pagesave të qirasë. Pas njohjes fillestare aktivi është kontabilizuar në përputhje me politikat kontabël të zbatuara për aktivin.

**e. Zhvlerësimi**

**i. Aktivet financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi dhe që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**ii. Aktivet jo-financiare**

Vlerat kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse ka ndonjë tregues të tillë, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga rënia e vlerës njihet në rast se vlera kontabël e aktivit tejkalon shumën e rikuperueshme. Rënia e vlerës njihet në fitim ose në humbje.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë duke i hequr kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, fluksi i ardhshëm monetar i llogaritur i zbritet vlerës aktuale duke përdorur normën e zbritjes para tatimit, e cila pasqyron vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet për aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë që njihen në periudhat e mëparshme, vlerësohen në çdo datë raportimi në rast se ka tregues se humbja ka rënë apo nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi ndryshon vetëm në rast se vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, vlerën neto të zhvlerësimit apo amortizimit, në rast se nuk ka humbje nga zhvlerësimi.

**3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

**f. Përfitimet e punëmarrësve**

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të Shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

**g. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

**h. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë humbjen nga kursi i këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen veçmas.

**i. Tatim fitimi**

Shpenzimi i tatim fitimit përfshin tatim fitimin e periudhës dhe tatim fitimin e shtyrë. Tatimi aktual dhe i shtyrë njihen drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Megjithatë, SKK 11: Tatimi mbi të Ardhurat lejon shoqëritë të zgjedhin nëse duan të njohin detyrime apo aktive tatimore të shtyra. Shoqëria ka zgjedhur të mos njohë këto detyrime apo aktive në përputhje me SKK 11.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës dhe ndonjë rregullim i detyrimit tatimor në lidhje me periudhat e kaluara.



#### **4. VLERËSIME DHE GJYKIME KRITIKE TË KONTABILITETIT**

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një rrezik të konsiderueshëm për shkak të një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

##### *Tatimi mbi fitimin*

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit fitimit. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i taksave është i pasigurtë. Shoqëria njihet detyrimet për çështjet e parashikuara tatimore të auditimit bazuar në vlerësimin nëse do të ketë shtesa në taksa. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon me shumat të cilat kanë qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatim fitimin aktiv dhe pasiv aktual në periudhën në të cilën bëhet një vlerësim i tillë.

##### *Vlera e drejtë e instrumenteve financiare*

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të cilat tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Shoqërisë nuk tregtohen në një treg aktiv) përcaktohet nga përdorimi i teknikave të vlerësimit. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të zgjedhur një shumëllojshmëri metodash dhe supozohet se janë kryesisht të bazuara në kushtet e tregut ekzistues në çdo datë bilanci.

## **5. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme për shkak të instrumentave financiarë që ajo përdor:

- risku i kreditit
- risku i likuiditetit
- risku i tregut.

Ky shënim shpjegues jep informacion në lidhje me ekspozimin e Shoqërisë ndaj risqeve të mësipërme, objektivat e Shoqërisë, politikat dhe proceset e matjes dhe manaxhimit të riskut si dhe manaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Informacione të tjera shpjeguese përfshihen në këto pasqyra financiare.

### ***Struktura e manaxhimit të riskut***

Manaxhimi ka një përgjegjësi të përgjithshme për përcaktimin dhe mbikqyrjen e strukturës së manaxhimit të riskut të Shoqërisë. Politikat e manaxhimit të riskut të Shoqërisë janë përcaktuar për të identifikuar dhe analizuar risqet me të cilat Shoqëria përballet, me qëllim që të përcaktojë limitet e risqeve dhe kontrollit, dhe të monitorojë risqet dhe përmbushjen e limiteve. Politikat e manaxhimit të riskut dhe sistemet janë të rishikuara rregullisht me qëllim që të reflektojnë ndryshimet në kushtet e tregut dhe të aktiviteteve të Shoqërisë.

Pa paragjykuar detyrimet dhe përgjegjësitë e manaxhimit të Shoqërisë, manaxhimi i Shoqërisë mëmë vlerëson se si manaxhimi monitoron përputhshmërinë me politikat dhe procedurat e riskut të Shoqërisë dhe rishikon përshtatshmërinë e strukturës së manaxhimit të riskut në krahasim me risqet që përballet Shoqëria.

### ***Risku i kreditit***

Risku i kreditit është risku i humbjes financiare në qoftë se një klient apo një palë e tretë në lidhje me instrumentat financiarë nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale të cilat lindin kryesisht nga kërkesat e Shoqërisë ndaj KESH-it për periudhën 15-vjecare të marrëveshjes.

### ***Risku i likuiditetit***

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të hasë vështiresi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet e saja financiare që mund të kërkojnë daljen e parave apo aktiveve të tjera financiare. Përpjekjet e Shoqërisë për manaxhimin e riskut të likuiditetit është të sigurojë, aq sa është e mundur, që do të ketë likuiditet të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj, si në kushte normale ashtu dhe në kushte të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme ose rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

**5. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

***Risku i tregut***

Risku i tregut është risku i ndryshimit në çmimet e tregut siç janë normat e kurseve të këmbimit, kryesisht të monedhës EURO, normat e interesit, kapitali dhe çmimet e mallrave, do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë. Objektivi i manaxhimit të riskut të tregut është manaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj këtij risku brenda parametrave të pranueshëm dhe duke optimizuar xhiron. Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj riskut të tregut për shkak të kushteve kontraktuale të përcaktuara në marrëveshjen konçesionare. Ajo është e ekspozuar ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit dhe të normave të interesit si për detyrimet e borxhit financiar dhe për arkëtimet financiare të marrëveshjes së konçesionit, të cilat janë të shprehura në Euro, e për këtë arsye paraqesin një mbrojtje ekonomike midis arkëtimeve të konçesionit dhe detyrimeve financiare.

***Risku i interesit***

Shoqëria përballet me riskun e flukseve monetare të interesave të lidhura me instrumentet financiare me norma të ndryshueshme.

***Risku i kurseve të këmbimit***

Shoqëria ndërmerr transaksione kryesisht në Euro. Risku i kurseve të këmbimit manaxhohet duke përdorur parimet e përputhshmërisë së aktiveve/detyrimeve. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë kontratë derivative këmbimi forward ose produkte derivative fikse deri më 31 dhjetor 2010.

***Analizat e ndjeshmërisë***

Nëpërmjet manaxhimit të riskut të monedhës dhe të normave të interesit, Shoqëria synon që të zvogëlojë luhatjet e fitimit/humbjeve në periudhën afatshkurtër. Ndërsa në periudhën afatgjatë ndryshimet në kurset e këmbimit dhe në normat e interesit mund të kenë efekt në fitim/humbje. Me 31 dhjetor 2010 dhe 2009 është vlerësuar se një ndryshim i përqindjes së normave të interesit dhe i vlerës së lekut kundrejt valutave të huaja nuk do të ketë ndonjë ndikim të konsiderueshëm në fitimin përpara tatimit.

***Manaxhimi i kapitalit***

Politika e Shoqërisë është që të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besimin e investitorit, kreditorëve dhe tregut dhe të mbështesë zhvillimet e ardhshme të biznesit. Manaxhimi i Shoqërisë mëmë monitoron kthimin nga kapitali, të cilin Shoqëria e quan si të ardhura operative neto të pjestuara me kapitalin aksionar.

17  


**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

**6. MJETE MONETARE NË ARKË DHE BANKË**

Mjete monetare në arkë dhe bankë janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Llogari rrjedhëse		
Në Lek	2,370,634	4,049,331
Në Euro	11,077,031	-
Depozita me afat	4,471,432,271	-
<b>Totali</b>	<b>4,484,879,936</b>	<b>4,049,331</b>

**7. AKTIVE TË TJERA AFATSHKURTRA**

Aktive të tjera afatshkurtra janë detajuar si më poshtë:


	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
TVSH e arkëtueshme	1,073,043,103	14,730,025
Parapagime për tatim fitimin	7,181,514	110,000
Parapagime ndaj furnitorëve	958,050	788,846
<b>Totali</b>	<b>1,081,182,667</b>	<b>15,628,871</b>

**8. PARAPAGIME DHE SHPENZIMET TË SHTYRA**

Në parapagimet dhe shpenzimet e shtyra është regjistruar parapagimi i shumës së garancise në lidhje me kredinë e dhënë nga Verbund International Finance B.V. ("VIF") dhe EVN AG me një vlerë totale prej 48 milion Euro. Sipas marrëveshjes së kredisë, Shoqëria duhet të parapaguajë 2% të shumës totale të tërhequr.

**9. MAKINERI DHE PAJISJE**

Makineritë dhe pajisjet, më 31 dhjetor 2010 përbëhen nga pajisje telekomunikacioni dhe mjete e paisje zyre me vlerë 1,939,532 Lek.



**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsytrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***10. AKTIVE AFATGJATA NË PROÇES**

	<b>Aktive në proçes</b>
<b>Kosto</b>	
<b>Më 1 janar 2009</b>	-
Kapitalizimi i punimeve të ndërtimit	3,811,061,774
Kapitalizimi i kostos së borxhit	79,000
<b>Më 31 dhjetor 2009</b>	<u>3,811,140,774</u>
Kapitalizimi i punimeve të ndërtimit	9,039,563,050
Kapitalizimi i kostos së borxhit	165,039,420
<b>Më 31 dhjetor 2010</b>	<u>13,015,743,244</u>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>	
<b>Më 1 janar 2009</b>	-
Amortizimi i vitit	-
Pakësime	-
<b>Më 31 dhjetor 2009</b>	<u>-</u>
Amortizimi i vitit	-
Pakësime	-
<b>Më 31 dhjetor, 2010</b>	<u>-</u>
<b>Vlera kontabël neto</b>	-
<b>Më 1 janar 2009</b>	<u>-</u>
<b>Më 31 dhjetor 2009</b>	<u>3,811,140,774</u>
<b>Më 31 dhjetor 2010</b>	<u>13,015,743,244</u>

Kostoja e ndërtimit prej 9,039,563,050 Lek përbëhet nga të gjitha shpenzimet e kryera gjatë periudhës aktuale, përfshirë këtu blerjen e tokës, tarifat e liçensimit, punimet inxhinierike, pajisjet elektrike dhe hidro-mekanike, konsulenca, projektimi dhe zbatimi i projektit, VNM dhe monitorimi ekologjik, si dhe studimi i kantierit.

19



**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***11. HUATË AFATGJATA**

Huatë afatgjata janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Hua nga VIF	3,356,695,132	-
Hua nga EVN AG	3,356,695,132	-
<b>Totali</b>	<b>6,713,390,264</b>	<b>-</b>

Me 15 tetor 2010, Shoqëria nenshkroi dy marrëveshje huaje, një me Verbund International Finance B.V. ("VIF") dhe një me EVN AG për një shumë kredie maksimale prej 70 milion Euro për secilën hua. Të dyja huatë kanë një normë interesi të barabarte prej EURIBOR 3m + 1.35%.

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
<i>Detyrimi afatshkurtër</i>		
Detyrimi afatshkurtër nga VIF	23,410,243	-
Detyrimi afatshkurtër nga EVN AG	23,410,244	-
	<b>46,820,487</b>	<b>-</b>
<i>Detyrimi afatgjatë</i>		
Detyrimi afatgjatë nga VIF	3,333,284,888	-
Detyrimi afatgjatë nga EVN AG	3,333,284,889	-
	<b>6,666,569,777</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>6,713,390,264</b>	<b>-</b>

**12. TË PAGUESHME NDAJ PALËVE TË LIDHURA**

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Të pagueshme ndaj palëve të treta	4,580,194,408	1,449,936,591
Të pagueshme ndaj partnerëve dhe aksionarëve	4,194,703	-
<b>Totali</b>	<b>4,584,389,111</b>	<b>1,449,936,591</b>

Llogaria detyrime ndaj palëve të lidhura përfaqëson një llogari të përbashkët ndërmjet Shoqërive të VERBUND Group. Lëvizjet e llogarisë kanë të bëjnë me pagesat e faturave dhe pagesat ndaj palëve të treta dhe transaksionet ndërmjet Shoqërive të grupit. Llogaria detyrime ndaj palëve të lidhura është një llogari në Euro e cila mbart një interes me normë Euribor 1-mujor + 2.4%.

**13. TË PAGUESHME NDAJ FURNITORËVE**

Në të pagueshme ndaj furnitorëve janë regjistruar pagesat për furnitorët për shërbimet e kryera gjatë vitit 2010. Furnitori kryesor është Shoqëria "Porr". Shuma e detyrimit ndaj shoqërisë "Porr" më 31 dhjetor 2010, është 533 milion Lek dhe përbën 67% të gjendjes totale së kësaj llogarie.

20  


**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsytrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***14. DETYRIME TË TJERA**

Detyrime të tjera përbëhen nga zërat e mëposhtëm:

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Shpenzime të përlllogaritura	858,608,910	1,130,440,613
Tatimi mbi të ardhurat e personelit	190,689	8,000
Sigurime shoqërore	187,710	20,245
Taksa të tjera dhe detyrime	77,011	310,177
Detyrime ndaj punonjësve	-	63,040
Kontribute nga Shoqëria mëmë	-	1,162,336,500
Detyrime të tjera	123,200	-
<b>Totali</b>	<b>859,187,520</b>	<b>2,293,178,575</b>

Shpenzimet e përlllogaritura janë shpenzime të regjistruara për punimet e ndërtimit, për të cilat nuk janë marrë faturat deri më 31 dhjetor 2010. Gjendja e shpenzimeve të përlllogaritura përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Investime kapitale	856,354,258	1,122,085,001
Shërbime	1,609,732	3,520,894
Shpenzime të tjera operative	644,920	4,834,718
<b>Totali</b>	<b>858,608,910</b>	<b>1,130,440,613</b>


**15. DETYRIM PËR KOMISJON MIRËMBAJTJE**

Detyrimi për komisjon mirëmbajtje konsiston në tarifën e llogaritur si 5% i çdo fature të lëshuar nga ana e furnitorit. Në bazë të marrëveshjes kontraktuale midis palëve shuma e përgjithshme e kësaj tarife do të paguhet në përfundimin e punimeve.

**16. SHPENZIMET TË PERSONELIT**

Shpenzimet e personelit janë detajuar si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010
Shpenzime për pagat	16,835,876	800,000
Shpenzime për sigurimet shoqërore	995,268	139,062
<b>Totali</b>	<b>17,831,144</b>	<b>939,062</b>



**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsytrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***17. SHPENZIMET E TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT**


Shpenzimet e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit janë detajuar si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010</b>
Shpenzime mirëmbajtje dhe riparimi	61,231,382	16,746,127
Shërbime për konsulencë profesionale	17,511,303	14,319,668
Shpenzime qiraje	10,084,277	2,092,689
Shpenzime për publicitet, reklama	6,177,210	7,996,802
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	2,458,065	26,898
Shpenzime përfaqësimi	1,688,815	52,955
Taksa dhe tarifa të tjera	1,164,040	60,708
Shpenzime për materiale zyre	753,911	383,904
Shërbime zyre	481,930	26,494
Penalitete	384,290	10,000
Shpenzime për komisione bankare	233,576	255,378
Shpenzime për sigurime	15,500	-
Shpenzime transporti	2,785	-
<b>Totali</b>	<b>102,187,084</b>	<b>41,971,623</b>

**18. (HUMBJE)/FITIME NGA KURSET E KËMBIMIT, NETO**

(Humbjet)/fitimet nga kurset e këmbimit janë detajuar si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010</b>
Humbje nga kurset e këmbimit	(129,736,084)	(21,673,276)
Fitiimi nga kurset e këmbimit	34,083,614	25,700,040
<b>Neto</b>	<b>(95,652,470)</b>	<b>4,026,764</b>





**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

**19. TATIM FITIMI**

Në bazë të nenit 27 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 për "Tatimin mbi të Ardhurat" humbjet e rezultuara mund të mbulojnë me fitimet në tre periudhat e ardhshme tatimore. Kjo humbje nuk mund të mbartet nëse gjatë periudhës tatimore pronësia e drejtpërdrejte dhe/ose indirekte e kapitalit themeltar ose e të drejtave të votës ndryshon me më shumë se 25% në vlerë ose në numër.

Më poshtë është rakordimi i humbjes së tatueshme dhe llogaritja e tatim fitimit të vitit.

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009</b>
Humbja kontabël	(215,434,059)	(38,456,580)
Korrigjime për diferenca të përkohëshme që do të zbriten në periudhat e ardhshme	(8,382,726)	7,330,426
Efektet tatimore të shpenzimeve të pazbritshme për qëllime të tatimit (penalitetet, qera dhe shpenzimet të tjera)	19,629,038	4,631,309
<b>Humbja tatimore</b>	<b>(204,187,746)</b>	<b>(26,494,845)</b>
<b>Tatim fitimi</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Norma e tatim fitimit për vitin, në bazë të normës standarde sipas ligjit fiskal në Shqipëri është 10% (2009: 10%). Shpenzimi i tatim fitimit për vitin mund të rakordohet me fitimin kontabël si më poshtë:

	<b>2010</b>	<b>Norma efektive e tatimit</b>	<b>2009</b>	<b>Norma efektive e tatimit</b>
<b>Humbja për vitin</b>	<b>(215,434,059)</b>		<b>(38,456,580)</b>	
Tatimi mbi fitimin bazuar në normat efektive korrente	(21,543,406)	10%	(3,845,658)	10%
Shpenzime të pazbritshme	1,962,904	-1%	463,131	-1%
Humbjet aktuale për të cilat nuk njihet shpenzim për tatim fitimin e shtyrë	20,418,775	-9%	2,649,485	-7%
Ndryshime në diferencat e përkohshme të panjohura	(838,273)	0%	733,043	-2%
<b>Shpenzimet e tatim fitimit për periudhën</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Humbjet e pasuara për vitet 2009 dhe 2010 nuk mund të mbarten pasi Shoqëria ka ndryshuar strukturën e aksionerëve me më shumë se 25%.

**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsytrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***20. TRANSAKIONET ME PALËT E LIDHURA**

Nje palë quhet e lidhur me një shoqëri nëse, në mënyre direkte ose indirekte, nëpërmjet një ose më shumë ndërmjetës, pala kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën të njëjtin kontroll me shoqërinë; ka një interes në shoqëri, e cila i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi shoqërinë; ose ka kontroll të përbashkët mbi shoqërinë; pala është një pjesëmarrje e Shoqërisë; pala është një sipërmarrje e përbashkët, në të cilën Shoqëria është një sipërmarrës; pala është një anëtar i personelit drejtues të Shoqërisë ose mëmës së saj.

Transaksionet me Verbund International në shumën prej 818,971 mijë Lek janë pasqyruar në koston e aktiveve në proces. Transaksione të tjera me Verbund International në shumën prej 21,609 mije Lek përfshihen në shpenzimet e përgjithshme administrative të Shoqërisë për vitin 2010.

Transaksionet me Verbund Finanzierungsservice në shumën prej 1,822 mijë Lekë përfshihen në shpenzimet e përgjithshme administrative të Shoqërisë për vitin 2010.

**21. GARANCITË DHE ANGAZHIMET**

Shoqëria nuk ka asnjë angazhim ligjor deri më 31 dhjetor 2010.

*Angazhimi nën Marrëveshjen e Konçesionit*

Sipas marrëveshjes së konçesionit të nënshkruar midis Shoqërisë dhe Qeverisë së Shqipërisë, Shoqëria gëzon të drejtën të hartojë, të financojë dhe të ndërtojë hidrocentralin. Kostoja totale e përlllogaritur e projektit deri më 31 dhjetor 2010 arrin në 205.2 milion. Minimumi i përlllogaritur i pagesave të ardhshme, më 31 dhjetor 2010, është detajuar më poshtë:

	2010		2009	
	EUR '000	Lek '000	EUR '000	Lek '000
Brenda një viti	78,241	10,857,504	55,776	7,694,831
Pas një viti, por jo më shumë se pesë vjet	33,104	4,593,842	124,750	17,210,575
	<b>111,345</b>	<b>15,451,346</b>	<b>180,526</b>	<b>24,905,406</b>

**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsytrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***21. GARANCITË DHE ANGAZHIMET (VAZHDIM)***Angazhimet e qirasë*

Më 31 dhjetor 2010, Shoqëria ishte palë në marrëveshjen e qirasë operative të lidhur për marrjen me qera të zyrave, e cila përfundon në dhjetor 2012. Pagesat minimale të ardhshme sipas marrëveshjes janë si më poshtë:

	2010	2009
Brenda një viti	5,210,310	4,741,409
Pas një viti por jo më shumë se pesë vjet	4,641,943	9,482,819
<b>Totali</b>	<b>9,852,253</b>	<b>14,224,228</b>

**22. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR****(i) Risku i kredisë dhe përqëndrimi**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kredisë.

Ekspozimi ndaj riskut të kredisë:

Shuma e mbartur e aktiveve financiare përfaqëson maksimumin e ekspozimit financiar. Maksimumi i ekspozimit financiar në datën e raportimit është:

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Aktive të tjera afatshkurtra	1,081,182,667	15,518,871
Mjete monetare në arkë dhe bankë	4,484,879,936	4,049,331
<b>Totali</b>	<b>5,566,062,603</b>	<b>19,568,202</b>

Ekspozimi ndaj riskut të kredise në datën e raportimit dhe sipas rajonit gjeografik ishte:

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
Vendas	5,566,062,603	19,568,202
Jo vendas	-	-
<b>Totali</b>	<b>5,566,062,603</b>	<b>19,568,202</b>

**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsytrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***22. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(ii) Risku i kursit të këmbimit**

Shoqëria kryen transaksione në Lek dhe në Euro. Risku i kursit të këmbimit matet nëpërmjet parimit të krahasimit të aktiveve/detyrimeve dhe nëpërmjet kontributit personal të aksionarëve. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë marrëvshje derivative forward apo fikse deri me 31 dhjetor 2010.

Ekspozimi i Shoqërise ndaj kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 është:

31 dhjetor 2010	Vlera e mbartur	Ekuivalenti në LEK (Të emëruara në EUR)	
		EUR	Lek
Aktive të tjera afatshkurtra	1,081,182,667	-	1,081,182,667
Mjete monetare në arkë dhe bankë	4,484,879,936	4,482,509,304	2,370,632
Huatë afatgjata	(6,666,569,777)	(6,666,569,777)	-
Të pagueshme ndaj furnitorëve	(798,423,205)	(798,157,725)	(265,480)
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	(4,584,389,111)	(4,584,389,111)	-
Ripagesat e huave afatgjata	(46,820,487)	(46,820,487)	-
Detyrime të tjera	(859,187,520)	(859,187,520)	-
<b>Ekspozim Neto</b>	<b>(7,389,327,497)</b>	<b>(8,472,615,316)</b>	<b>1,083,287,819</b>

31 dhjetor 2009	Vlera e mbartur	Ekuivalenti në LEK (Të emëruara në EUR)	
		EUR	Lek
Aktive të tjera afatshkurtra	15,518,871	748,847	14,770,024
Mjete monetare në arkë dhe bankë	4,049,331	-	4,049,331
Të pagueshme ndaj furnitorëve	(233,994)	(233,994)	-
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	(1,449,936,591)	(1,449,936,591)	-
Detyrime të tjera	(2,293,178,575)	(1,127,985,190)	(1,165,193,385)
<b>Ekspozim Neto</b>	<b>(3,723,780,958)</b>	<b>(2,577,406,928)</b>	<b>(1,146,374,030)</b>

Kurset e këmbimit të mëposhtme janë aplikuar gjatë vitit:

Lek	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2010	2009	2010	2009
USD 1	103.94	94.90	104.00	95.81
EURO 1	137.79	132.04	138.77	137.96

**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsytrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

*(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***22. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(ii) Risku i kursit të këmbimit (vazhdim)***Analiza e ndjeshmërisë ndaj monedhës së huaj*

Analiza e meposhtme e ndjeshmërisë është percaktuar në bazë të ekspozimit ndaj valutës së huaj në datën e raportimit dhe në ndryshimet e percaktuara që bëhen në fillim të vitit financiar e të mbajtura të pandryshuara gjatë periudhës së raportimit. Më poshtë është një paraqitje e ndikimit të ndryshimeve në kursin e këmbimit në fitimin neto, duke konsideruar të gjithë faktorët të tjera konstante:

	2010	2009
EUR zhvlerësohet me 10%	847,261,532	257,740,693
EUR vlerësohet me 10%	(847,261,532)	(257,740,693)

**(iii) Risku i likuiditetit**

Shoqëria duhet të ketë gadishmëri në burimet e veta të parave (cash), kryesisht nga kostot operative që lindin, nga aktivitetet e tij të prodhimit dhe tregtimit. Si rrjedhim, ekziston një risk që paraja nuk do të jetë e mjaftueshme për të paguar detyrimet kur lindin me një kosto të arsyeshme. Shoqëria monitoron likuiditetin e saj në baza periodike në mënyrë që të manaxhojë detyrimet e saj kur maturohen. Shoqëria e manaxhon riskun e saj kryesisht nëpërmjet kontributeve të pronarëve.

Më poshtë janë maturitetet kontraktuale të aktiveve financiare dhe detyrimeve duke përfshirë pagesat e interesit më 31 dhjetor 2010 dhe 2009:

<i>31 dhjetor 2010</i>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>6 Muaj ose më pak</b>	<b>6-12 Muaj</b>	<b>1-5 Vjet</b>	<b>Më shumë se 5 vjet</b>
<i>Aktive financiare</i>					
Aktive të tjera afatshkurtra	1,081,182,667	958,050	-	1,080,224,617	-
Mjete monetare në arkë dhe bankë	4,484,879,936	4,484,879,936	-	-	-
	<b>5,566,062,603</b>	<b>4,485,837,986</b>	<b>-</b>	<b>1,080,224,617</b>	<b>-</b>
<i>Detyrime financiare</i>					
Ripagesat e huave afatgjata	(46,820,487)	(46,820,487)	-	-	-
Të pagueshme ndaj furnitorëve	(798,423,205)	(798,423,205)	-	-	-
Të pagueshme ndaj palevëve të lidhura	(4,584,389,111)	(4,584,389,111)	-	-	-
Huatë afatgjata	(6,666,569,777)	-	-	(6,666,569,777)	-
Detyrim për komision mirëmbajtje	(164,832,471)	-	-	(164,832,471)	-
Detyrime të tjera	(859,187,520)	(859,187,520)	-	-	-
	<b>(13,120,222,571)</b>	<b>(6,288,820,323)</b>	<b>-</b>	<b>(6,831,402,248)</b>	<b>-</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>(7,554,159,968)</b>	<b>(1,802,982,337)</b>	<b>-</b>	<b>(5,751,177,631)</b>	<b>-</b>

**Energji Ashta sh.p.k**

Shënime mbi paqsytrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

(Shumat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

**22. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(iii) Risku i likuiditetit (vazhdim)**

31 dhjetor 2009	Vlera kontabel	6 Muaj ose më pak	6-12 Muaj	1-5 Vjet	Më shumë se 5 vjet
<i>Aktive financiare</i>					
Aktive të tjera afatshkurtra	15,518,871	15,518,871	-	-	-
Mjete monetare në arkë dhe bankë	4,049,331	4,049,331	-	-	-
	<b>19,568,202</b>	<b>19,568,202</b>	-	-	-
<i>Aktive financiare</i>					
Të pagueshme ndaj furnitorëve	(233,994)	(233,994)	-	-	-
Të pagueshme ndaj palevëve të lidhura	(1,449,936,591)	(1,449,936,591)	-	-	-
Detyrime të tjera	(2,293,178,575)	(2,293,068,575)	-	-	-
	<b>(3,743,349,160)</b>	<b>(3,743,239,160)</b>	-	-	-
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>(3,723,780,958)</b>	<b>(3,723,670,958)</b>	-	-	-

**(iv) Risku i normave të interesit****Profili**

Në datën e raportimit profili i interesit dhe i instrumentave financiar mbartës të interesit të Shoqërise ishte:

	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2009
<b>Instrumentet me norma të ndryshueshme</b>		
Aktive financiare	-	-
Detyrime financiare	4,194,703	1,449,936,591
<b>Totali</b>	<b>4,194,703</b>	<b>1,449,936,591</b>

**Analizat e ndjeshmërisë së vleres së drejtë për instrumentat me norma fikse**

Shoqëria nuk llogarit ndonjë aktiv financiar ose detyrim me normë fikse në vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim humbje dhe ajo nuk përdor mjete derivativë si instrumente mbrojtjeje sipas modelit të kontabilizimit me vlerën e drejtë të instrumentave mbrojtës. Si rrjedhojë, një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikojë në llogarinë fitim humbje.

**23. NGJARJE PAS DATES SË RAPORTIMIT**

Nuk ka ngjarje të tjera të mëpasshme të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat kërkojnë korrjigim ose shënime në pasqyrat financiare.